



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA BULQIZE

KESHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr 10, datë 9 / 2 /2017

PER

PERFUNDIMIN E PROCEDURAVE TE PRIVATIZIMIT TE BANESAVE.

Në zbatim të ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 neni 24, pika 2, **“Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”**, bazuar në ligjin nr. 9232, datë 13.04.2004, neni 39/1, pika 4, **“Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”**, objekti ligjit nr. 7828, datë 01.06.1994, **“Për disa shtesa dhe ndryshime”** të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, **“Për privatizimin e banesave shtetërore”**, dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 97, datë 03.02.2008 **“Për procedurat e privatizimit të banesave”**, si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 45, datë 08.09.1995, **“Për ndarje banesash në qytetin Bulqizë”**, (banesa ne proces që nga viti 1992), në bazë të kërkesave të qytetarëve Sali BAJRAKTARI, Astrit ZOGU dhe Petrit BETA, Sektori i Strehimit në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, **Keshilli Bashkiak ne mledhjen e tij te dates 09.02.2017 pasi diskutoi rreth projektit te paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit te Territorit me 12 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim**

V E N D O S I:

1-Miratimin për përfundimin e procedurave të privatizimit të apartamenteve për lidhjen e kontratave të shitblerjes para noterit, për banesat të cilat kanë mbetur pa u regjistruar ne Zyrës së Regjistrimit te Pasurive të Paluajtshme, pas plotesimit të dokumentacionit përkatës si dhe pas pagesës së privatizimit për personat:

- | | |
|----------|------------|
| 1- Sali | BAJRAKTARI |
| 2-Astrit | ZOGU |
| 3-Petrit | BETA |

Ngarkoneti Kryetari i Bashkisë Bulqize ose personi i autorizuar prej tij, për pajtimin e kontratës së privatizimit, pas plotësimit të dokumentacionit përkatës.

2-Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga i Prefekti i Qarkut Dibër

PER KESHILLIN BASHKIAK

SEKRETARI
Agim TUCI



KRYETARI
Gazmend KENGA

